R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2400/5 prot. Tiranë, më 26.10.2026

V E N D I M

Nr. 43, datë 26.10.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Ankuesi "Alko Impex Contruction" sh.p.k., përfaqësuar nga z. (në vijim "ankuesi"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës me nr. 2400 prot., datë 27.08.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, me anë të kërkesës për informacion nr. 166 prot., datë 13.08.2026, të dërguar me shërbim postar, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni lidhur me statusin dhe historikun e regjistrimit, pronësinë, kategorinë dhe karakteristikat teknike të mjeteve të deklaruara nga operatori ekonomik fitues, në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt "Loti 2: Kontrata B "Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor"", konkretisht:

Për mjetin Ford Transit me targa dhe nr. shasie :

- *Të na bëhet me dije nëse ky mjet ka qenë i regjistruar dhe aktiv në regjistrin e mjeteve të administruar nga DPSHTRR në datën 11.06.2026;*
- *Të na bëhet e ditur data e regjistrimit të parë të këtij mjeti pranë DPSHTRR, si dhe nëse ka pasur çregjistrime dhe/ose riregjistrime, datat përkatëse;*
- *Të na bëhet me dije se në pronësi të cilit subjekt/person rezultonte mjeti në datën 11.06.2026, si dhe data e regjistrimit të pronësisë përkatëse;*

- *Të na vihet në dispozicion kopje të dokumentacionit/regjistrimeve që vërtetojnë statusin juridik dhe teknik të mjetit në datën 11.06.2026, përfshirë lejen e qarkullimit dhe të dhënat për kontrollin teknik, për aq sa këto të dhëna disponohen nga institucioni juaj.*

Për mjetin Mercedes-Benz, me targa dhe nr. shasie :

- *Të na bëhet me dije tipologjia/kategoria dhe destinacioni i përdorimit të mjetit që rezultonte e regjistruar në regjistrin e DPSHTRR në datën 11.06.2026, konkretisht nëse rezultonte i regjistruar si kamioçinë, borëpastruese apo me një emërtim/tipologji tjetër;*
- *Nëse mjeti është regjistruar ose përshtatur si borëpastruese, të na bëhet me dije data kur është kryer ky regjistrim, ndryshimin apo modifikim i karakteristikave teknike të tij;*
- *Të na bëhet me dije nëse përpara datës 11.06.2026 mjeti ka pasur një tipologji/kategori tjetër dhe, nëse po, të na bëhen me dije data dhe përmbajtja e çdo ndryshimi të kryer në të dhënat teknike të mjetit;*
- *Të na vihet në dispozicion kopje e dokumentacionit teknik dhe administrativ mbi bazën e të cilit është regjistruar dhe/ose ndryshuar tipologjia, destinacioni apo karakteristikat teknike të këtij mjeti;*
- *Të na vihet në dispozicion kopje e lejes së qarkullimit dhe/ose dokumentit tjetër përkatës nga i cili rezulton tipologjia dhe karakteristikat teknike të mjetit në datën 11.06.2026.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 19500/1 prot., datë 21.08.2026, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar se: *"...informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund të vihet në dispozicion, pasi kërkesa është paraqitur nga një subjekt të cilit nuk i përkasin mjetet për të cilat kërkohet informacion. Të dhënat lidhur me mjetet e regjistruara në pronësi të një subjekti përbëjnë informacion konfidencial që trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen të dhënave personale përkatësisht ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ky informacion nuk është informacion që sipas legjislacionit në fuqi duhet të bëhet publik. ...Në rastin konkret, ju nuk dispononi tagrin ligjor për të kërkuar dhe marrë këtë informacion, pasi nuk jeni subjekti të cilit i përkasin mjetet apo një institucion/autoritet i autorizuar nga ligji për marrjen e këtij informacion"*.

Ankuesi, pas përgjigjes, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI").

Në zbatim të nenit 24, pika 3, të LDI-së, si dhe në përputhje me parimin e dhënies së ndihmës aktive, të parashikuar në nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 2400/1 prot., datë 03.09.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 21158/1 prot., datë 10.09.2026, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2400/2 prot., datë 14.09.2026, ka kthyer përgjigje, duke mbajtur të njëjtin qëndrim me atë të shprehur në shkresën nr. 19500/1 prot., datë 21.08.2026, duke refuzuar dhënien e informacionit, me arsyetimin se: *"Kërkesa e shoqërisë konsiston në marrjen e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me mjetet me targa (e regjistruar në DRSHTRR Durrës) dhe (e regjistruar në DRSHTRR Tiranë), duke përfshirë të dhëna mbi pronësinë, historikun e regjistrimit, ndryshimet e pronësisë, të dhënat teknike dhe kopje të dokumenteve të regjistrimit dhe qarkullimit.*

Sipas Udhëzimit nr. 4, datë 28.06.2019 "Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore", i ndryshuar, të dhënat e mjetit dhe të pronarit evidentohen në sistemet dhe regjistrat elektronikë të administruar nga DPSHTRR, ndërsa dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin e mjetit përbën pjesë të dosjes së mjetit.

Për rrjedhojë, informacioni i kërkuar nuk është thjesht informacion i përgjithshëm mbi veprimtarinë e institucionit i cili mund të bëhet publik në bazë të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, por përfshin të dhëna individuale dhe dokumentacion të lidhur me mjete konkrete dhe me subjektet që rezultojnë të lidhura me to.

Në këtë drejtim, neni 17 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. përcakton rastet dhe kushtet në të cilat e drejta e informimit mund të kufizohet, në këtë rast informacioni i kërkuar lidhet me të dhëna dhe dokumentacion individual të mjeteve konkrete, të administruara në kuadër të regjistrave dhe procedurave të regjistrimit të mjeteve, dhe jo me informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e institucionit.

Ndërkohë, ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" vendos detyrimin për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre nga përpunimi apo komunikimi i paautorizuar.

Në rastin konkret, kërkuesi nuk është pronar i mjeteve objekt kërkese, nuk është subjekt i të dhënave dhe nuk ka paraqitur autorizim nga pronari apo ndonjë dispozitë ligjore konkrete që i njeh të drejtën për të marrë nga DRSHTRR Durrës dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara. Fakti që informacioni kërkohet në kuadër të një procedure prokurimi publik nuk krijon, në vetvete, një të drejtë të pakushtëzuar për akses në të dhënat dhe dokumentacionin që administrohet në regjistrat e mjeteve nga DRSHTRR. Çdo dhënie informacioni duhet të jetë në përputhje njëkohësisht me ligjin nr. 119/2014 dhe me detyrimet e institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë rast informacioni dhe dokumentacioni përkatës mund tu vihet në dispozicion strukturave kompetente për verifikim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, siç është

Autoriteti Rrugor Shqiptar, i cili ka të drejtën të verifikojë dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, duke kërkuar informacion pranë institucionit tonë ose Komisionit të Prokurimit Publik, në rast ankese nga ana juaj ose subjekte të tjerë.

Për sa më sipër, DRSHTRR Durrës vlerëson se informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi nuk mund t'i vihet në dispozicion këtij të fundit, pasi do të përbënte komunikim të të dhënave dhe dokumentacionit të administruar për një subjekt të tretë, pa një bazë ligjore specifike që autorizon këtë komunikim. DRSHTRR Durrës, në bazë të objektit të veprimtarisë që ushtron, nuk mund të kthehet në një zyrë ankesash të operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në procedura tenderimi. Një praktikë e tillë nuk mund të krijojë precedentë për raste të ngjashme".

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, ankuesi ka vijuar ankimin, regjistruar me nr. 2400/3 prot., datë 14.09.2026, me pretendimin se: *"DRSHTRR Durrës nuk ka marrë në konsideratë dallimin e evidentuar nga ana juaj në shkresën nr. 2400/1 prot., datë 03.09.2026, ndërmjet të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me një subjekt tregtar. Konkretisht, kërkesa e shoqërisë "Alko Impex Construction" sh.p.k. nuk ka pasur për objekt të dhënat personale të administratorit, përfaqësuesit ligjor apo të ndonjë personi tjetër fizik të lidhur me subjektin përkatës, por të dhëna dhe informacion që i përkasin një subjekti tregtar. Pavarësisht kësaj, DRSHTRR Durrës ka vijuar ta trajtojë informacionin e kërkuar si të dhënë personale dhe të mbrojtur nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, pa adresuar qëndrimin e shprehur nga ana juaj se të dhënat e subjekteve të regjistruara si person fizik tregtar ose person juridik, në bazë të legjislacionit tregtar, nuk konsiderohen të dhëna personale dhe, si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje sipas ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"".*

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 05.10.2026, me praninë e palëve, gjatë së cilës ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit nga Autoriteti Publik. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, në pretendimet e parashtruara gjatë seancës, rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në përgjigjet e sipërcituara.

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe pretendimeve të palëve, Komisioneri vlerëson çështjen në raport me dispozitat e LDI-së dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm, si më poshtë:

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe*

entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se informacioni i kërkuar nuk është thjesht informacion i përgjithshëm mbi veprimtarinë e institucionit, i cili mund të bëhet publik, por përfshin të dhëna individuale dhe dokumentacion të lidhur me mjete konkrete, vlerësojmë si në vijim.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1, përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike".* Në këtë kuptim, çdo autoritet publik, pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Pas shqyrtimit të objektit të ankimit, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas të cilit: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik"*.

Thënë kjo, vlen të theksojmë se LDI, edhe pse jo shprehimisht, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë; dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar. Në kategorinë e parë përfshihen ato kategori informacioni, të përcaktuara në nenin 7 të LDI-së, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa kategoria e dytë përfshin ato informacione, për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik. Kësisoj, LDI nuk e ka kufizuar të drejtën e informimit vetëm tek informacioni i përgjithshëm që publikohet sipas nenit 7 të tij, por në tërësinë e informacionit/dokumentacionit të administruar prej Autoritetit Publik. Në rastin konkret, informacioni objekt ankese bën pjesë në kategorinë e dytë të sipërcituar, i cili kërkohet në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI-së.

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të tij, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur.

Në lidhje me argumentin se kërkuesi nuk është pronar i mjeteve objekt kërkese, subjekt i të dhënave, si dhe nuk ka paraqitur autorizim nga pronari apo ndonjë dispozitë ligjore konkrete që i njeh të drejtën për të marrë informacionin e kërkuar, sjellim në vëmendje se LDI, bazuar në pikën 3 të nenit 2 dhe pikën 1 të nenit 3 të tij nuk përcakton cilësi të veçanta apo kritere që duhet të përmbushë kërkuesi për marrjen e informacionit. Në parim, çdo informacion publik është i hapur për publikun e gjerë, pavarësisht se cili është kërkuesi apo në çfarë cilësie e paraqet kërkesën. Parimi i transparencës shërben si rregull

në trajtimin e kërkesave për informacion, ndërsa përjashtimi nga ky rregull vlen vetëm në rastet kur vendosja në dispozicion e informacionit të kërkuar cenon një nga interesat e parashikuara nga neni 17 i LDI-së, cenimin e të cilit Autoriteti Publik duhet ta arsyetojë në mënyrë të plotë. Bazuar në sa më sipër, edhe ky pretendim gjendet i pambështetur në ligj.

Sa i takon pretendimit se të dhënat lidhur me mjetet e regjistruara në pronësi të një subjekti përbëjnë informacion konfidencial që trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen të dhënave personale, përkatësisht ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim LMDP), Zyra e Komisionerit vlerëson se ai nuk qëndron.

Fillimisht, konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar për mosdhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë për të gjitha informacionet/të dhënat e kërkuara nëse ato përbëjnë të dhëna personale apo jo, por është shprehur vetëm në mënyrë të përgjithshme se ato janë konfidenciale dhe trajtohen nga LMDP-ja. Ky pretendim, pa një analizë konkrete të informacionit të kërkuar, nuk përbën një shkak të mjaftueshëm ligjor për refuzimin e plotë të kërkesës për informim.

Në këtë drejtim, vlerësohet se zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bëhet në harmoni me dispozitat e LDI-së, duke mbajtur në konsideratë se kuadri ligjor për këto dy fusha synon mbrojtjen e interesave të ligjshëm, pa përjashtuar në mënyrë kategorike ushtrimin e së drejtës për informim. Për rrjedhojë, fakti që informacioni i kërkuar administrohet në regjistra ose dosje që përmbajnë të dhëna për persona të tjerë, nuk nënkupton, në vetvete, se i gjithë informacioni dhe dokumentacioni përkatës përbën informacion të përjashtuar nga e drejta për informim.

Ndërkohë, sqarojmë se jo çdo informacion i kërkuar përbën "të dhënë personale", në kuptim të pikës 3 të nenit 5 të LMDP-së, e cila përcakton se: *""E dhënë personale" është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash"*, si dhe pikës 23 të tij, që përcakton se: *""Subjekt i të dhënave" është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror"*.

Sa më sipër, Autoriteti Publik nuk ka vlerësuar nëse të dhënat lidhur me mjetet e regjistruara i përkasin një personi fizik, përfshirë personin fizik tregtar, apo një personi juridik. Bazuar në dispozitat e sipërcituara, të dhënat që lidhen ekskluzivisht me personat juridikë, si subjekte të mëvetësishme, nuk konsiderohen të dhëna personale në kuptim të LMDP-së. Ndërsa, për të dhënat që lidhen me personat fizikë tregtarë duhet të vlerësohet konkretisht natyra e informacionit dhe nëse ai lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Në këtë kuadër, merret në konsideratë edhe praktika e Zyrës së Komisionerit, ndër të tjera, përmes vendimeve nr. 16, datë 14.05.2026, nr. 22, datë 30.06.2026 dhe nr. 31, datë 14.08.2026, të cilat mund të aksesohen në faqen zyrtare të institucionit, në linkun https://idp.al/vendime-2026-informimi/.

Në këtë kuptim, të dhënat që lidhen ekskluzivisht me një person juridik, si subjekt i mëvetësishëm nga personat fizikë që e përfaqësojnë ose e administrojnë atë, nuk përbëjnë, vetëm për këtë shkak, të dhëna personale në kuptim të LMDP-së. Ndryshe paraqitet situata kur informacioni lidhet me një person fizik, përfshirë rastin kur ky ushtron veprimtari tregtare në emrin e tij.

Për më tepër, të dhënat që lidhen me mjetet e regjistruara nuk mund të cilësohen automatikisht as si të dhëna personale dhe as si informacion i përjashtuar nga aksesi publik. Vlerësimi i natyrës së tyre kërkon të merret në konsideratë konteksti në të cilin përpunohen, si dhe mundësia që, nëpërmjet lidhjes me regjistrat përkatës, të identifikohet një person fizik dhe të përftohet informacion që lidhet me të. Për këtë arsye, është e nevojshme të dallohet informacioni mbi karakteristikat teknike, kategorinë, destinacionin e përdorimit dhe statusin e regjistrimit të mjetit nga informacioni që identifikon drejtpërdrejt ose tërthorazi pronarin person fizik apo persona të tjerë fizikë.

Sa i takon informacionit mbi pronësinë dhe dokumentacionit shoqërues, vlerësimi duhet të marrë në konsideratë nëse të dhënat përkatëse identifikojnë një person juridik apo një person fizik, si dhe nëse dokumentet përmbajnë elemente që mund të cenojnë një interes të mbrojtur ligjërisht. Në rastin e fundit, Autoriteti Publik duhet të identifikojë konkretisht interesin që mund të cenohet dhe të arsyetojë përmbushjen e kushteve ligjore për kufizimin e aksesit, në vend që të mbështetet vetëm në faktin se dokumentacioni lidhet me një mjet të regjistruar në emër të një subjekti të tretë.

Në këtë drejtim, neni 17 i LDI-së përcakton kushtet në të cilat mund të kufizohet e drejta për informim, duke kërkuar, sipas rastit, që kufizimi të jetë i domosdoshëm dhe proporcional, si dhe që dhënia e informacionit të cenojë interesin e mbrojtur nga ligji. Për rrjedhojë, referimi i përgjithshëm te LMDP-ja nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Publik për të kryer vlerësimin konkret të kërkesës sipas LDI-së, duke identifikuar informacionin që mund të vihet në dispozicion dhe atë pjesë për të cilën mund të ekzistojë një shkak i ligjshëm kufizimi.

Megjithatë, edhe në rast se në dokumentacionin e kërkuar ka të dhëna personale të personave fizikë, kjo nuk justifikon automatikisht refuzimin e plotë të informacionit. Autoriteti Publik duhet të vlerësojë mundësinë e dhënies së pjesshme të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI-së, ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Ky parashikim sanksionon detyrimin për të zbatuar kufizimet në mënyrë të pjesshme, kur kjo është e mundur, në vend të refuzimit të plotë të informacionit. Për rrjedhojë, nëse leja e qarkullimit, dokumentacioni teknik ose dokumentet e tjera të kërkuara përmbajnë të dhëna personale të personave fizikë, Autoriteti Publik duhet të vlerësojë mundësinë e redaktimit ose të anonimizimit të këtyre të dhënave, duke vendosur në dispozicion pjesën tjetër të informacionit të kërkuar.

Në lidhje me argumentin e Autoritetit Publik se fakti që informacioni kërkohet në kuadër të një procedure prokurimi publik nuk i jep ankuesit të drejtën për të aksesuar dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR dhe se verifikimi i këtij dokumentacioni i përket Autoritetit Rrugor Shqiptar ose Komisionit të Prokurimit Publik, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky argument nuk mund të shërbejë si shkak për përjashtimin e zbatimit të LDI-së. Kompetencat që legjislacioni për prokurimin publik u njeh autoriteteve dhe organeve kompetente për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë nuk përjashtojnë të drejtën e çdo personi për t'iu drejtuar autoriteteve publike për informacionin që ato prodhojnë ose mbajnë, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara nga legjislacioni për të drejtën e informimit.

Gjithashtu, pretendimi i Autoritetit Publik se nuk mund të shndërrohet në një "zyrë ankesash të operatorëve ekonomikë" nuk lidhet me objektin e detyrimit që buron nga LDI-ja. Në rastin konkret, ankuesi nuk i ka kërkuar DRSHTRR-së të shqyrtojë ligjshmërinë e procedurës së prokurimit, të vlerësojë ofertën e operatorit fitues apo të marrë një vendim lidhur me vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur në atë procedurë, por t'i vendosë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e administruar nga ky autoritet publik për dy mjete konkrete.

Një kërkesë e i tillë nuk mund të refuzohet mbi bazën e konsideratave të përgjithshme lidhur me mundësinë e krijimit të precedentëve, por vetëm nëse ekzistojnë shkaqe konkrete dhe të argumentuara për kufizimin e së drejtës për informim, në përputhje me parashikimet e nenit 17 të LDI-së.

Në vlerësimin e kësaj çështjeje, rëndësi të veçantë merr edhe fakti se informacioni kërkohet në lidhje me mjete të deklaruara nga operatori ekonomik fitues në një procedurë prokurimi publik, me qëllim verifikimin e të dhënave dhe dokumentacionit të paraqitur në atë procedurë. Kjo rrethanë përbën një element me rëndësi në vlerësimin e interesit publik për njohjen me informacionin, pasi lidhet me verifikimin e saktësisë së të dhënave të paraqitura dhe transparencën e një procedure që synon përdorimin e fondeve publike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri vlerëson se refuzimi i plotë i informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Publik nuk është i justifikuar në përputhje me dispozitat e LDI-së. Autoriteti Publik nuk ka argumentuar në mënyrë konkrete ekzistencën e shkaqeve ligjore që justifikojnë kufizimin e aksesit për secilën kategori informacioni dhe nuk ka vlerësuar mundësinë e dhënies së pjesshme të dokumentacionit, sipas nenit 17, pika 6, të LDI-së.

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik duhet të garantojë aksesin në informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar që prodhon ose mban, duke zbatuar, sipas rastit, kufizimet e ligjshme dhe duke vënë në dispozicion pjesën e informacionit që nuk i nënshtrohet këtyre kufizimeve.

Si përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës së shoqërisë "Alko Impex Contruction" sh.p.k., përfaqësuar nga z. , me nr. 2400 prot., datë 27.08.2026, ndaj Autoritetit Publik "Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit sipas kërkesës për informacion nr. 166 prot., datë 13.08.2026, brenda datës 02.11.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 26.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi